



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë më ____ . 01. 2022

L ë n d a : Informacion mbi masat e marra dhe veprimet e kryera nga strukturat e Policisë së Shtetit para, gjatë dhe pas protestës së datës 08.01.2021 në Tiranë.

MINISTRIT TË BRENDSHËM

ZOTIT BLENDAR ÇUÇI

TIRANË

I nderuar Zoti Ministër,

Më lejoni t'Ju informoj lidhur me masat e marra dhe veprimet e kryera nga strukturat e Policisë së Shtetit para, gjatë dhe pas protestës së datës 08.01.2021, në Selinë e Partisë Demokratike dhe pranë saj në Tiranë.

Nisur nga njoftimet në media dhe bazuar në shkresën nr.01, të datës 04.01.2022, të Komisionit të Përkohshëm të Rithemelimit të subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë, drejtuar DVP Tiranë, nëpërmjet të cilës bënte me dije për zhvillimin e një proteste te Selia e Partisë Demokratike në datën 08.01.2022, nga ora 12.⁰⁰ deri në ora 16.⁰⁰, nga strukturat e Policisë së Shtetit, u planifikuan një sërë masash, duke filluar me takimet e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit me drejtuesit e lartë të strukturave të saj dhe të DVP Tiranë, nëpërmjet të cilës është analizuar situata dhe informacionet paraprake që administrojnë strukturat e Policisë së Shtetit, agjencitë e tjera ligj zbatuese apo edhe që qarkullonin në media të ndryshme.

Nga ana e DVP Tiranë, si strukturë policore në territorin e të cilës parashikohej të zhvillohej ky aktivitet, u shkëmbye korrespondenca zyrtare me Komisionin e Përkohshëm të Rithemelimit, lidhur me plotësimin e kërkesave të parashikuara në Ligjin nr. 8773, datë 23.04.2001 "Për tubimet".

Konkretisht shkresat e DVP Tiranë përmbledhen si më poshtë:

- Me shkresën nr. 01/1 datë 05.01.2022, DVP Tiranë i ka kthyer përgjigje organizatorëve për plotësim të njoftimit sipas kërkesave të pikës 2, të nenit 5 të Ligjit nr. 8773, datë 23.04.2001 "Për tubimet".
- Megjithëse organizatorët plotësuan disa nga kërkesat ligjore në njoftimin e tyre, përsëri DVP Tiranë me shkresën nr. 01/4 datë 07.01.2022, i ka kthyer përgjigje organizatorëve për plotësim të të gjithë elementëve të kërkuar sipas pikës 2, të nenit 5 të Ligjit nr. 8773, datë 23.04.2001 "Për tubimet".
- Me shkresë nr. 01/6 datë 07.01.2022, DVP Tiranë i ka bërë me dije Komisionit të Përkohshëm të Rithemelimit të subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë, adresuar z. Flamur Noka

se nisur nga informacionet mediatike dhe ato që administronte Policia e Shtetit, gjatë zhvillimit të protestës mund të kishte dhunë, përplasje fizike, shkatërrim/dëmtim prone etj., veprime të cilat përbënin rrezik për sigurinë kombëtare dhe publike, jetën dhe shëndetin e shtetasve, cënimin e rendit dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të shtetasve të tjerë. I janë bërë të ditura edhe përgjegjësitë që ka si organizator i protestës në bazë të Ligjit nr. 8773, datë 23.04.2001 “Për tubimet” dhe i është kërkuar bashkëpunim për mbarëvajtjen e protestës.

- Me shkresë nr. 01/7 datë 07.01.2022, “Kërkesë për bashkëpunim”, DVP Tiranë adresuar Z. Gazmend Bardhi Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Demokratike, i ka bërë prezent informacionin e ardhur në “Komisariatit digital”, por edhe që ka qarkulluar në media se në ambientet e selisë së PDSH, ka sende dhe mjete të kundërligjshme si dhe persona të dyshimtë të cilët mund të kryejnë akte dhune ditën e protestës. Për këtë i është dërguar një foto ku i është kërkuar bashkëpunim për verifikimin e saj, evidentimin e personave të dyshimtë dhe largimin e sendeve dhe mjeteve të kundërligjshme të cilat rrezikonin jetën e tyre dhe të shtetasve të tjerë.
- Me këtë shkresë z. Gazmend Bardhit i është kërkuar gjithashtu akses në monitorimin e kamerave të brendshme dhe rreth saj të selisë së PDSH, me qëllim monitorimin e personave të dyshimtë dhe të dhunshëm dhe reagim të shpejtë në rast situatë, por nuk morëm asnjë reagim zyrtarë nga ana e këtij të fundit apo personave të tjerë nga kjo parti.
- Është njoftuar zyrtarisht Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Garda e Republikës, Prefekti i Qarkut Tiranë dhe Bashkia e Tiranës.

Për përballimin e situatës dhe garantimin e rendit e sigurisë publike gjatë zhvillimit të kësaj proteste, nga ana e strukturave qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, u morën dhe ndoqën këto masa:

- U hartua Plani i Masave me Nr. 14 datë 07.01.2022, i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit “Për garantimin e rendit dhe sigurisë publike gjatë zhvillimit të tubimit para selisë së subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë, në Tiranë më datë 08.01.2022”. Në këtë plan u përcaktuan detyrat konkrete për DVP Tiranë dhe strukturat pjesëmarrëse nga të gjitha departamentet përfshi dhe strukturat e FLO-së, struktura të tjera operationale, vendvendosjen e tyre dhe kohën e dislokimit, mjetet dhe pajisjet, veprimet që do të kryeshin, drejtuesi i këtyre shërbimeve, duke planifikuar edhe situatat e të papriturave etj.
- Departamenti i Policinë Kriminale në bashkëpunim me Departamentin e Sigurisë Publike, hartoi Telegramin e DPPSH nr. 13, datë 06.01.2022, drejtuar drejtorive vendore të policisë, në vend lidhur me marrjen e informacioneve dhe planifikimin e masave nga ana e tyre.
- U hartuan shkresa për njoftim dhe bashkëpunim për administrimin e informacionit lidhur me këtë protestë me disa institucione si me SHISH, SHÇBA, AISM, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve me qëllim marrjen e masave edhe nga ana e tyre etj.
- Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit strukturat qendrore, DVP Tiranë dhe repartet e varësisë së Drejtorisë së FLO-së u vendosën në gatishmëri “Në shërbim të përforcuar nga ora 08:00-20:00 të datës 08.01.2022”.
- Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit u ngrit Grupi i Drejtimit në DPPSH nga ora 08.⁰⁰ të datës 08.01.2022, në të cilin është mbajtur protokollin i të gjithë veprimeve të kryera nga strukturat e Policisë së Shtetit, në terren.
- Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, u mbajtën disa takime dhe komunikime me drejtuesit e institucioneve ligj zbatuese të vendit dhe ndërkombëtare, lidhur me informacionet që ato administronin për këtë protestë, me qëllim planifikimin e masave.
- Në Departamentin e Policinë Kriminale dhe Drejtorinë e Antiterrorit u ngritën grupe pune lidhur me monitorimin e mediave, siteve dhe burimeve të tjera të hapura.

- U studiuan edhe njëherë Kodi i Procedurës Penale, ligji nr. 8580 datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, ligjit nr. 8773, datë 23.04.2001 “Për tubimet”, si dhe aktet nënligjore në fuqi, lidhur me kompetencat që ka Policia e Shtetit në rast të nevojës për ndërhyrje me qëllim parandalimin e veprave penale në një seli të një partie politike.
- U bashkëpunua edhe me shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin dhe shërbimin mjekësor për të mbajtur në gatishmëri automjete të tyre pranë Hotel “Plazza”, për çdo nevojë dhe të papritur.

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, në zbatim të detyrimeve ligjore hartoi Planin e Masave me nr. 01/11, datë 07.01.2022 “Për sigurimin e rendit dhe qetësisë publike në institucionet e rëndësishme, Tiranë, gjatë zhvillimit të protestës më datën 08.01.2022”, duke planifikuar punonjës policie (punonjës të rendit publik, të policisë kriminale dhe policisë rrugore), i cili ju dërgua për zbatim komisariateve të policisë në varësi të DVP Tiranë. Instruktimi dhe dhënia e detyrave për personelin policor është kryer në orën 10.⁰⁰ nga shefat e komisariateve të policisë përkatës dhe drejtues të DVP Tiranë për personelin e këtyre strukturave.

Punonjësit e policisë dhe mjetet e shërbimit u dislokuan kryesisht pranë objekteve: “Piramida”; ish Hotel “Dajti”; ish ATSH; Rruga “Xhorxh Bush”; pranë dy kullave; Rruga “Papa Gjon Pali”, në Selinë e Parlamentit me qëllim që të ishin pranë selisë së PD-së etj., si dhe u mbajtën grupe rezerve në komisarifat e policisë nr. 1, 2, 3. Po kështu u ngritën dhe funksionuan pika kontrolli në segmentet hyrëse dhe dalëse të qytetit të Tiranës.

Edhe pse protesta ishte njoftuar të niste në orën 12.⁰⁰, ajo filloi rreth orës 11.³⁰, ku pranë selisë së PD-së (brenda territorit përpara saj), u grumbulluan një numër i konsiderueshëm personash mbështetës të ish kryetarit të PD-së z. Sali Berisha, duke mbushur dhe rrugën e unazës pranë kësaj selie. Në këto kushte nga drejtuesi i shërbimeve të DVP Tiranë, është ri urdhëruar që edhe grupet rezervë që ishin në komisarifat e policisë nr. 1, 2 dhe 3, të afroheshin pra në pika të caktuara për të qenë në gatishmëri (Kryeministria; Kuvendi; kryqëzimi i Rrugës së Elbasanit/pranë katedrales katolike).

Që në nisje pjesëmarrësit në këtë tubim/protestë filluan të kryejnë veprime të dhunshme. Ata penguan të hyjë në godinën e PDSH, z. Roland Bejko drejtues në atë parti dhe më pas filluan të godasin/sulmojnë objektin/godinën e PD-së, shkatërruar dhe dëmtuar dyert, dritaret me mjete të forta, përdorën shkallë për të hipur në kat të dytë të ndërtesës duke dëmtuar xhamat e dritareve etj.

Në vlerësim të situatës së krijuar (dhe të transmetuar drejtpërdrejt edhe nga disa media vizive), si dhe të kërkesës për ndihmë nga drejtues dhe përfaqësues të PD-së të cilët gjendeshin brenda në Selinë e PD-së, të adresuara në Sallën Operative të DPV Tiranë, tek pika e kontaktit Zëvendësdrejtori për Sigurinë Publike në atë strukturë, apo edhe tek Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, nga fakti që nuk ka pasur një kërkesë zyrtare të mëparshme nga ky subjekt, paraprkasht është kërkuar që të bëjnë publike “nevojën për ndërhyrje nga Policia e Shtetit” dhe pasi është realizuar kjo, është bërë njoftim për shtyp nga Policia e Shtetit me përmbajtjen: **“Në bazë të një kërkesë të bërë Policisë së Shtetit, nga një grup deputetësh të Partisë Demokratike, të cilët kanë kërkuar ndihmën e Policisë, pasi i rrezikojnë jeta nga protestuesit, sqarojmë se: Policia e Shtetit është gati për të ndërhyrë në ndihmë të deputetëve që kanë kërkuar ndihmë dhe u bën thirrje protestuesve që të distancohen menjëherë nga aktet e shkatërrimit të pronës dhe aktet e dhunës.**

Policia e Shtetit u bën thirrje organizatorëve të protestës që të përmbajnë protestuesit dhe të shmangin çdo rast dhune, sepse do përballen me ligjin”.

Mbas transmetimit të këtij njoftimi, Policia e Shtetit ka vijuar të bëjë thirrje nëpërmjet artoporlantit të vendosur në tarracën e Sallës së Parlamentit, me megafon dhe nëpërmjet punonjësve të policisë.

Rreth orës 12.⁵⁵ të datës 8.01.2022 me urdhër të drejtuesit të shërbimeve, është ndërhyrë nga shërbimet e policisë me uniformë të DVP Tiranë nga ana e Sallës së Kuvendit të Shqipërisë, të cilët kanë bërë zmbarsjen e protestuesve për një distancë të shkurtër, duke u përballur me kundërveprime e veprime të dhunshme të tyre.

Në këto kushte është marrë vendimi nga drejtuesi i shërbimeve në terren (Drejtori i Departamentit për Sigurinë Publike) për tërheqjen e efektivave të rendit të DVP Tiranë dhe janë urdhëruar për të ndërhyrë efektivat e FLO-së, ndërsa efektivat e rendit publik kanë vepruar nga pas efektivave të FLO-së (Reparti i NSH Tiranë). Në zbatim të detyrave funksionale në rastet e tubimeve dhe të protestave, ky repart ka zbatuar taktikat policore për largimin e protestuesve nga rreziku i dëmtimit të shtetasve që ndodheshin në Selinë e PD si deputetë, femra dhe shtetas të tjerë, duke ndërprerë shkatërrimin e mëtejshëm të objektit, duke bërë thirrje për ndërprerjen e veprimeve të dhunshme ndaj selisë, por edhe hedhjen e sendeve të forta ndaj punonjësve të policisë, duke përdorur forcën në mënyrë proporcionale si duke shtyrë protestuesit.

Me gjithë paralajmërimet e protestuesve dhe përdorimin e shi hedhësve për të ndërprerë veprimet e kundërligjshme dhe shpërndarjen e tyre, përsëri ata kanë vazhduar duke goditur me sende të forta automjetet dhe punonjësit e policisë, dëmtuar dyert, dritaret e pjesë të tjera të selisë së PD-së. Në këto kushte janë përdorur lëndë lakrimogjene, në zbatim të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, akteve nënligjore të dala në zbatim të tij dhe të procedurës standarde të miratuar me Urdhër nr.10, datë 8.01.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Përdorimi i lëndëve lakrimogjene”, të cilat bënë të mundur shpërndarjen dhe largimin e protestuesve nga selia e PD-së.

Megjithëse protestuesit u larguan jashtë oborrit/territorit të selisë të PD-së, përsëri qëndronin të grumbulluar dhe qëllonin me sende të forta në drejtim të punonjësve të policisë, në këtë situatë është urdhëruar shpërndarja e tyre me ujë nëpërmjet shi hedhësve të cilët kanë bërë të mundur largimin e zhvendosjen e grupimeve/protestuesve deri në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit”.

Pas shpërndarjes protestuesit u rigrupuan pranë Kryeministrisë, kanë lëvizur tek kryqëzimi i Radiotelevizionit Shqiptar, INIMA, pas Piramidës dhe kanë tentuar të kalojnë tek Selia e PD-së nëpërmjet Urës pranë ETC, (Vodafone), por nuk janë lejuar nga grupet e Reparteve të NSH, të cilët kanë qenë të dislokuar në unazë në krah të urës. Kjo situatë vazhdoi për disa minuta deri në shpërndarjen dhe largimin e protestuesve.

Gjatë kësaj kohe shërbimet e DVP Tiranë morën masa për:

- Rrethimin me shirit të vendit të ngjarjes në Selinë e PD-së, njoftuan drejtuesin e prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ngritën grupet e punës për këqyrjen e vendit të ngjarjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale për dëmtimet e ndodhura dhe autorët e shkatërrimit të tyre, ku i pranishëm ishte drejtuesi i prokurorisë Tiranë dhe prokurori i gatshëm.

- Vendosën shërbime policie dhe bllokuan Urën e Vodafonit, Urën në Rrugën e Elbasanit, Urën e Hotel Dajtit, duke mos lejuar lëvizjen e protestuesve.
- Shqyrtimin e pamjeve filmike nga secili komisarariat policie i DVP Tiranë, nxjerrja e fotove për identifikimin, evidentimin e personave konkretë që kanë kryer veprime të dhunshme ndaj objektit të Selisë të PD-së dhe Policisë së Shtetit dhe marrjen e masave për gjetjen e shoqërimin e tyre në ambientet e Komisariateve të Policisë.
- Kapjen e shoqërimin e personave që gjendeshin në ambientet e brendshme të Selisë të PD-së.

Gjatë protestës u evidentuan dëmtime të lehta për :

- Dy punonjës të policisë të strukturave të rendit publik të DVP Tiranë, si rezultat i përdorimit të gazit lotsjellës dhe përdorimi i sendeve të forta (gurë, shkopinj), të cilët pas mjekimit u larguan në banesë.
- Nëntë protestues, si rezultat i përdorimit të gazit lotsjellës, një protestues i rrëzuar nga shkallët dhe një tjetër pretendonte se ishte dëmtuar/goditur nga punonjësit e FNSH-së.

Nga ana e strukturave të DVP Tiranë dhe të forcave të tjera pjesëmarrëse në këtë shërbim, u shoqëruan në ambientet e policisë **82 shtetas**, nga të cilët u arrestuan **në flagrancë 24** dhe u ndaluan **10**, proceduan në gjendje të lirë **18 persona**.

Gjithashtu, u referuan materialet procedurale në organin e prokurorisë në ngarkim të:

- Shtetasit **Gazmend Bardhi** për veprat penale: *“Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive”*; *“Stërvitja për prodhim dhe përdorim të paligjshëm të armëve e lëndëve të tjera të rrezikshme”*.
- Shtetasit **Flamur Noka** për veprat penale: *“Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme”*; *“Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit”*.
- **Ndaj 49 shtetasve të tjerë** për veprat penale: *“Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme”*; *“Prishja e rendit dhe qetësisë publike”*; *“Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit”*; *“Shkatërrimi i pronës”*; *“Prodhimi mbajtja, blerja apo shitja armëve të ftohta”*.

Sqarojmë se për shtetasit e arrestuar dhe ndaluar gjatë protestës Gjykata e Rrethit Gjyqsor Tiranë ka vlerësuar si të ligjshëm të gjitha arrestet dhe ndalimet e kryera nga Policia e Shtetit.

Në përfundim të analizës së kryer për këtë shërbim, janë evidentuar disa konkluzione për anët pozitive, për disa të meta dhe mangësi, por edhe për disa problematika të konstatuara gjatë veprimeve të shërbimeve të strukturave të Policisë së Shtetit, konkretisht:

Anët pozitive:

- Ruajtja e gjakftohtësisë nga ana e punonjësve të policisë ndaj protestuesve të cilët kanë sharë, ofenduar, provokuar, etj., si dhe qëndrim etik dhe profesional.
- Realizimi në nivelin e duhur të bashkëpunimit midis shërbimeve të DVP Tiranë dhe shërbimeve të tjera operationale të Policisë së Shtetit.
- Bashkëpunimi i mirë me Gardën e Republikës dhe agjenci të tjera ligj zbatuese.
- Kryerja e veprimeve procedurale në bashkërendim me organin e prokurorisë në kohën e duhur.
- Bashkëpunimi me mediat e shkruara dhe vizive për të transmetuar në kohë thirrjet, paralajmërimet e policisë, si dhe për korrektësinë e veprimeve të kryera nga policia.

Mangësi e problematika:

- Sistemi i komunikimit me radio ndërlidhje në kanalën e caktuar për drejtuesit e strukturave qendrore të Policisë së Shtetit - nuk funksionoi gjatë gjithë zhvillimit të protestës.
- Përdorimi i mjeteve shi hedhëse dhe i lëndëve lakrimogjene duhet të planifikohet më mirë dhe në çdo rast përdorimi i tyre të bëhet vetëm me urdhër dhe komandë nga drejtuesit e shërbimeve jo me iniciativë të punonjësve të policisë që i përdorin ato.
- Strukturat vendore të DVP Tiranë duhet të ndërhyjnë dhe vepronin që në momentet e para për t'u përballur me turmën, si dhe kryerje të veprimeve më të shpejta në sigurimin e vendit të ngjarjes, identifikimin dhe shoqërimin e personave të dhunshëm.
- Nevoja për trajnim të personelit policor të strukturave të rendit publik në menaxhimin e përballjen me tubime e aktivitete masive të kësaj natyre.
- Punonjësit e policisë që përdorin radio për komunikim, duhet të pajisen me kufje për komunikim të shpejtë, pasi mbajtja e radios në dorë vështirëson kryerjen e veprimeve të tjera nga punonjësi i policisë.
- Filtrat e kundërgazeve të personelit policor të DVP Tiranë nuk e kryen plotësisht funksionin e duhur për shkak të konsumimit dhe qëndrimit të gjatë në magazina.
- Domosdoshmëri e disponimit nga Policia e Shtetit të mjeteve/pajisjeve kufizuese për bllokimin e segmenteve të caktuara rrugore, devijimin e trafikut etj.
- Informacionet e DVP tjera lidhur me personat e "dhunshëm" që marrin pjesë në këto aktivitete në Tiranë, duhet të shoqërohen dhe me foto të tyre.
- Në të tilla tubime/protesta ku marrin pjesë dhe mbështetës nga qarqet e tjera, duhet që DVP të dërgojnë me shërbim punonjës policie të cilët i njohin këta persona dhe mbajnë në kontroll.

Në zbatim të Planit të Masave të hartuar në këtë shërbim, u angazhuan **728** punonjës policie dhe **96** automjete, nga të gjitha strukturat qendrore dhe të DVP Tiranë që morën pjesë.

I nderuar Zoti Ministër,

Ballafaqimi dhe zgjidhja e një situatë si kjo e datës 8.01.2022 nga Policia e Shtetit është hera e parë që ndodh në një seli të një partie politike dhe si e tillë nga ana jonë u vlerësua maksimalisht sepse sikundër Ju e thatë në fjalën Tuaj në datën 13 Janar 2022 në ceremoninë e 109 vjetorit të krijimit të Policisë së Shtetit **"duke zbatuar një standard të lartë profesionalizimi dhe autonomie", një situatë ku ishte e vështirë të ndaje kufirin se ku mbaronte e drejta për të protestuar, ku mbaronte e drejta për të ushtruar lirisht aktivitetin politik dhe detyrimin për të parandaluar dhe shmangur çdo pasojë kriminale kundër personave apo pronës"**.

Me gjithë vlerësimet pozitive që mori Policia e Shtetit, qoftë nga Kryeministri, Ministri i Brendshëm apo edhe nga disa institucione ndërkombëtare, në analizat që kemi zhvilluar kemi konstatuar disa problematika (të cilat u shtjelluan më lart), për të cilat më Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit kemi ngritur grupin e punës për rishikimin e procedurës standarde të miratuar me Urdhër nr.1034, datë 31.10.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit **"Planifikimi i shërbimeve të policisë gjatë zhvillimit të tubimeve"**, me qëllim që në të ardhmen të evitohen raste të ngjashme në protesta të kësaj natyre.

Duke Ju falënderuar për vëmendjen.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHETIT

Konceptoi & Printoi.
Data 17.01.2021

Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit
Drejtues i Lartë Albert DERVISHAJ

Kopje: 2 (dy)
Lidhje: S'ka

SPYETJET.AL